



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



CA

KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 6661 Prot

Shkodër me 25.09 2025

VENDIM

Nr. 22, Datë 24.09.2025

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN 8/MUJORE JANAR- GUSHT TË VITIT 2025, PËR KËSHILLIN E QARKUT SHKODËR

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për periudhën 8/mujore janar- gusht të vitit 2025, për Këshillin e Qarkut Shkodër", bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Ligjin 115/2024 "Per Buxhetin e Vitit 2025", VKQ Shkoder nr.26, datë 20.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027", VKQ Shkoder nr.6, datë 13.03.2025 "Mbi disa ndryshime ne VKQ nr.6, date 20.12.2024- Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027", Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relativitetit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me 16 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,

VENDOSI;

1. Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të 8/mujorit të vitit 2025 dhe tabelat e realizimit të buxhetit, pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;
 - a) Raportin e shpenzimeve sipas programeve.
 - b) Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve.